

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SHPK PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 2317/3 prot., datë 21.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 6.6.2023, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 6.6.2023.

- Me shkresën protokolluar në ERE me nr. 2317 prot., datë 30.10.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 2317/1 prot., datë 7.11.2024, duke i evidentuar informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2317/2 prot., datë 8.11.2024, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria me korrespondencën vijuese të realizuar me ERE-n, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pika 8 të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. bëhet znj. Freda Doçi.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti